Republika e Kosovës-
Republika Kosova - Republic of Kosovo
Qeveria –Vlada – Government

Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve
Nacionalni Autoritet za Kvalifikacije
National Qualification Authority

Numër: 01-469
Datë: 16.11.2016

Në mbështetje të neneve 15, pika 2, dhe nenit 17, pikat 1.5, 1.6 të Ligjit nr. 03/L-060 mbi Kualifikimet Kombëtare dhe Udhëzimit Administrativ nr. 35/2014 të datës 20. 11. 2014 mbi Kriteret dhe procedurat për validimin dhe aprovimin e kualifikimeve kombëtare dhe akreditimin e institucioneve që ofrojnë kualifikime në Kosovë me nenet 9, 12, 13, 14, 15, dhe 18, Këshilli Drejtues i Autoritetit Kombëtar të Kualifikimeve me datë 31.10.2016 nxjerr këtë:

Vendim

1. Miratohet kërkesa për lejim për aplikim për validim dhe akreditim të institucionit për ato kualifikime për të cilat ekzistojnë standardet e profesionit të miratuara në nivel kombëtar, ndërsa për kualifikimet nga fusha e teknologjisë informative duhet të sjellin Marrëveshjet e Bashkëpunimit me zhvilluesin e kualifikimit si dëshmi se ka leje për shfrytëzim.

2. Shkollës profesionale për Programim "PROED" nuk i lejohet që të aplikojë për validim dhe akreditim të institucionit për kualifikimin Profesionist për gjuhë programuese dhe zhvillim softueri, pasi që nuk ka sjellë si dëshmi Marrëveshjen ndërkombëtare për lejim të shfrytëzimit të kualifikimit nga zhvilluesi i tij.

3. Autoriteti Kombëtar i Kualifikimeve është i obliguar që të njoftojë institucionin për përgatitjen e aplikimit dhe të vazhdojë procesin sipas legjislacionit në fuqi.

4. Vendimi hyn në fuqi me datën e nënshkrimit të tij.

5. Vendimi u dërgohet të gjitha palëve të interesit.

Nën- kryetari i KD së AKK
Anton Gojani